



Strehëza për gra dhe vajza të abuzuara

Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë
SOROS

Ky Buletin është botuar me mbështetjen financiare të SOROS

Rrjeti për zbatimin e dënimeve alternative

Newsletter 2, 2010.

Seminare informuese për Shërbimin e Provës. www.NCSO-AL.org

Hyrje

Zbatimi i Dënimit Alternativ në Shqipëri është një hap përpara në konsolidimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit ligjor. Janë arritur shumë objektiva prej një viti nga bashkëpunimi mes Shërbimit të Provës dhe Rrjetit të Shërbimeve Komunitare për të dënuarit. Në qendër të projektit kanë qenë shumë aktivitete të ndryshme si seminare informuese, workshope, takime, prezantime, fushata ndërgjegjësimi si dhe trajtime e mbikëqyrje të rasteve konkrete.

Këto aktivitete kanë pasur një efekt pozitiv në bashkëpunimin e Rrjetit me Shërbimin e Provës, në ndërtimin e kapaciteteve për rehabilitimin dhe riintegrimin e ish të dënuarve. Rrjeti ka siguruar profesionalizëm midis palëve si dhe ka rritur nivelin e ndërgjegjësimit publik për zbatimin e Dënimit Alternativ në komunitet.



Hotel "Mondial", Tiranë

Në kuadër të projektit "Rrjeti Kombëtar për Zbatimin e Dënimeve Alternative" shoqatat partnere organizuan një prezantim si pjesë e marrëveshjes së memorandumit të bashkëpunimit me Shërbimin e Provës. Ky aktivitet u organizua në Hotel "Mondial", më datën 27 Korrik 2010. Në këtë aktivitet morën pjesë punonjës të Shërbimit të Provës nga Drejtoria e Përgjithshme dhe drejtoritë rajonale që janë ngritur deri tani në rrethet Tiranë, Durrës, Fier, Shkodër, si dhe nga përfaqësues të organizatave partnere të projektit. Në takim mori pjesë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, zoti Arben Sefgjini. Në këtë aktivitet u prezantua Projekti "Rrjeti Kombëtar për Zbatimin e Dënimeve Alternative" si dhe të gjitha aktivitetet e parashikuara me Shërbimin e Provës nga Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës

"Aksion Plus", zoti Genci Mucollari. Në prezantimin e tij, zoti Sefgjini si Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës foli për rëndësinë e ngritjes së një institucioni të tillë dhe vuri theksin në rëndësinë e riintegritit që Shërbimi i Provës realizon për ata persona, të cilët marrin një dënim alternativ si dhe ul pasojat që mund të sjellë burgimi.





Shkodër

Në kuadër të projektit “ Rrjeti Kombëtar Për Dënimet Alternative në Shqipëri” u zhvillua në qytetin e Shkodrës një seminar informues për shërbimet që ofrohen nga disa organizata partnere të shoqërisë civile në kuadër të zbatimit të masave që ndërmerren mbi Dënimet Alternative. Seminari u zhvillua më datën 26.11.2010 në hotel “ Europa”. Në seminar morën pjesë, Gjyqtarë, Prokurorë, Psikologë, Juristë, Avokatë, Gazetarë, Drejtori i Shërbimit të Provës, Specialistë të Shërbimit të Provës, Drejtori Ekzekutiv i “Aksion +”, Drejtoresha Ekzekutive e Shoqatës “Përthyerja”, Punonjëse Sociale dhe Psikologe të shoqatave bashkëpunuese.

Në këtë takim u diskutua rreth Memorandumit të Bashkëpunimit që në kuadër të këtij projekti është nënshkruar me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës; Programet e ndryshme të trajtimit si ai me metadon; terapitë afatshkurtëra dhe afatgjata, për personat që marrin masa alternative të burgimit.



Fier

Në kuadër të projektit “Rrjeti Kombëtar për Dënimet Alternative në Shqipëri” në qytetin e Fierit më datën 21.09.2010 në hotel “Fieri” u zhvillua seminari me temë “Seminar informues për shërbimet që mbulojnë nga disa organizata të shoqërisë civile në kuadër të zbatimit të Masave Alternative të Dënimit”. Në seminar morën pjesë përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimit të Provës Fier, Prokurorë të Gjykatës Fier dhe pjestarët e stafit të projektit.

Në këtë takim u diskutua rreth Memorandumit të Bashkëpunimit që në kuadër të këtij projekti është nënshkruar me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës; Programet e ndryshme të trajtimit si ai me metadon; terapitë afatshkurtëra dhe afatgjata, për personat që marrin masa alternative të burgimit.



Universiteti “Aleks Luarasi”, Tiranë

Më datën 15.11.2010 në Universitetin Aleks Luarasi u zhvillua një prezantim në kuadër të projektit Zbatimi i Dënimit Alternativ. Ky prezantim u realizua si bashkëpunim ndërmjet Qendrës së Kërkimeve Shkencore të këtij Universiteti dhe Shoqatave zbatuese të projektit.

Në këtë takim morën pjesë drejtori ekzekutiv i Aksion Plus, z. Genci Mucollari, inspektori i Shërbimit të Provës, z. Sajmir Shyti, punonjësjë sociale znj. Enkelejda Ngjelina dhe znj. Fiona Lalaj, lektore në Fakultetin e Shkencave Politike.

Gjatë takimit u parashtrua rëndësia, qëllimi, objektivat e projektit dhe bashkëpunimi me Shërbimin e Provës.



Universiteti “Wisdom”

Më datën 07.12.2010 në Universitetin “Wisdom”, në Tiranë u zhvillua një prezantim në kuadër të projektit “Rrjeti Kombëtar për Zbatimin e Dënimeve Alternative”. Ky prezantim u realizua si bashkëpunim ndërmjet Qendrës së Kërkimeve Shkencore të këtij Universiteti dhe shoqatave zbatuese të projektit.

Takimi u drejtua nga Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës Aksion Plus, z.Genci Muçollari si dhe bashkëpunëtorë të tjerë të projektit, znj. Entela

Kaleshi, znj. Enkelejda Ngjelina dhe znj. Fiona Lalaj.

Çështjet kryesore të prezantimit ishin, qëllimi i krijimit të Shërbimit të Provës, baza ligjore e veprimtarisë së tij, struktura dhe organizimi i përgjithshëm, parimet bazë të funksionimit të tij, kompetencat, memorandumit i bashkëpunimit me shoqatat e rrjetit në kuadër të zbatimit të Dënimit Alternativ, avantazhet që paraqet ky shërbim në raport me alternativën burgim.



Durrës

Në kuadër të projektit “Rrjeti Kombëtar për Dënimet Alternative në Shqipëri” në qytetin e Durrësit, në datën 12.11.2010 në hotel “Aragosta” u zhvillua seminari me temë “Seminari informues për shërbimet që mbulohen nga disa organizata të shoqërisë civile në kuadër të zbatimit të Masave Alternative të Dënimit”.

Në seminar morën pjesë gjyqtarë të fushës penale, prokurorë të Gjykatës së Durrësit, Drejtori i

Shërbimit të Provës Durrës, Drejtori i Shërbimit të Provës Tiranë, Drejtori Ekzekutiv Aksion +, Drejtoresha Ekzekutive e Shoqatës Përthyerja si dhe përfaqësues të tjerë të Drejtorisë së Shërbimit të Provës dhe përfaqësues të rrjetit.

Gjatë takimit u parashtrua rëndësia, qëllimi, objektivat e projektit dhe bashkëpunimi me Shërbimin e Provës.

Alternativat ndaj Burgimit

Ne perpjekjen për të minimizuar apo eliminuar tregjet e paligjshme të trafikimit të drogës politikat e ndryshme qeverisëse mbeshtesin për qasjen sipas së cilës sanksionet apo dënimet penale për përdoruesit e drogës dhe fuqizimi i legjislacionit dhe zbatimi me rigorozitet lidhur me këto fenomene do të reduktojnë numrin e përdoruesve të drogës dhe veprat penale lidhur me to. Kështu, burgimi përben alternativën me të rëndësishme në politikën qeverisëse të parandalimit të drogës sigurisht duke iu referuar specifikave të shteteve përkatëse. Në vitet e fundit është shtuar ndjeshëm numri i personave të arrestuar për vepra penale që kanë lidhje me drogën. Në këto kategori mund të përmendim Shtetet e Bashkuara që sipas statistikave rezultojnë se më tepër se gjysma e të burgosurve janë dënuar për vepra penale në lidhje me drogën. Gjithashtu, vende si ato të Europës, Azisë, Afrikës karakterizohen nga e njëjta problematikë.

Kombet e Bashkuara dhe Sistemi i Kontrollit të Drogës mbajnë të pandryshuar qëndrimin ndaj masave penale me burgim për veprat penale në lidhje me drogën. Në raportin e përvitshëm, përkatësisht të vitit 2007, Bordi Nderkombëtar i Kontrollit të Narkotikëve ashtu sikurse edhe Konventa për Drogën në vitin 1988 në kuadër të legjislacionit të hartuar për këto qëllime inkurajojnë zbatimin e detyrueshëm të sanksioneve penale sipas ligjeve vendase në raport me kryerjen e veprave penale në lidhje me drogën (neni 3 i kësaj konvente).

Pavarësisht zbatimit të këtyre dispozitave, alternative të vetme të burgimit për përdoruesit e drogës, ka manifestuar problematika të shumta ndër të cilat mund të rendisim, koston financiare, mungesën e efektivitetit në trajtimin apo parandalimin e drogës si fenomen, probleme shëndetësore e sociale. Megjithatë rigorozitetin e Konventave në lidhje me Kontrollin Nderkombëtar të Drogës në dispozitat përkatëse ka hapësirë për fleksibilitet në të cilat trajtimet me karakter shëndetësor e psikosocial janë parashikuar të aplikohen së bashku apo të zevendesojnë vendimet penale.

PROBLEMET E MANIFESTUARA SI REZULTAT I PËRQINDJEVE TË LARTA TË BURGOSJES:

Kosto Financiare, mbipopullimi i burgjeve, impakti i kufizuar në reduktimin e përdorimit të drogës si dhe pasojat e rënda socio-ekonomike dhe shëndetësore.



REKOMANDIME

- 1- Ligjet dhe ndëshkimet për përdoruesit e drogës duhen rishikuar me synimin për të krijuar një ndarje të qartë midis aktorëve të ndryshëm dhe rolit që do të luajnë në tregun e drogave të jashtëligjshme. Ndërhyrjet mbi forcimin e ligjit dhe dënimet me burg duhet të përqendrohen më tepër tek të pandehurit e dhunshëm, ndërsa qeveritë duhet të vendosin në përdorim depenalizimin dhe dekriminalizimin për personat e parrezikshëm.
- 2- Duhet të përdoren mekanizmat e diversionit në arrestim në mënyrë që çështjet e një niveli të ulët të mos krijojnë mbingarkesë dhe të shfuqizojnë sistemin e drejtësisë kriminale.
- 3- Dënimet me burg duhet të reduktohen ose të zhvendosen tek të pandehurit e një niveli të ulët, të cilët do t'i nënshtrohen formave më të përshtatshme të ndërhyrjeve. Kjo do të përfshinte ndëshkime administrative për përdoruesit për efekt çlodhje ose shërbim trajtimi për personat që kanë krijuar varësi nga droga. Çdo procedurë kriminale që rrit presionin për kalimin në burg, siç janë dënimet mandatore dhe ndalimet para gjyqit, duhet të përdoren vetëm për rastet më serioze.
- 4- Trajtimi i përdorimit të drogës nuk duhet parë më si një krim, por si një problem shëndetësor. Duhet të kalojmë nga forma ndëshkimore në trajtim për sa u takon përdoruesve të drogës, të cilët nuk janë të përfshirë në krime të dhunshme.